

**V E N D I M N r. 7**

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË  
“ALBCHROME HOLDING” SH.P.K.**

Sot, më datë 08.11.2021 (dymijë e njëzet e një), në selinë e Shoqërisë “**AlbChrome Holding**” Sh.p.k. me NUIS L51320005G (më tej referuar si “**Shoqëria**”), në adresën “*Rr. Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Ap. Nr.3, Tiranë*” u paraqitën palët e mëposhtme ortake të Shoqërisë:

**Balfin Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar pranë Regjistrimit Tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit K72223031K, me seli në ‘*Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Kati 11, Tiranë*’, përfaqësuar rregullisht nga **Znj. Edlira MUKA**, shtetase shqiptare, lindur më datë 03.02.1983, në Tiranë, mbajtëse e dokumentit të identifikimit me Nr. 025864525 (dhe me nr. Personal: I35203147R), madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton z. Fatos Kaleshi, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë (më tej referuar si “**Ortaku**”), zotëruese në masën 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të **Shoqërisë**, për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901, datë 14.03.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, i ndryshuar (‘Ligji nr.9901/2008’), dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

**REND DITE:**

- 1. ZMADHIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË.**
- 2. TË NDRYSHME.**

\*\*\*\*\*

Duke kaluar në diskutimin e çështjeve të rendit të ditës, Kryetari i Asamblesë parashtron se Ortaku do të kontribuojë në Shoqëri, brenda një afati 5 ditor nga data e këtij vendimi, një vlerë totale prej 23,440,640 (njëzet e tre milion katërqind e dyzet mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë, e cila do të shkojë për rritjen e kapitalit të Shoqërisë ‘Albchrome Holding SHPK’. Duke qënë se kërkohet kapitalizimi i këtyre kontributeve nga Ortaku, lind nevoja për miratimin e rritjes së kapitalit, duke e zmadhuar vlerën e kapitalit të Shoqërisë me shumën prej 23,440,640 (njëzet e tre milion katërqind e dyzet mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë. Pas një vlerësimi të kujdesshëm të të gjitha parashtrimeve dhe diskutimeve të zhvilluara, Asambleja e Përgjithshme,

**VENDOSI:**

- Të miratojë zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë, sa më sipër, në një vlerë të barabartë me 23,440,640 (njëzet e tre milion katërqind e dyzet mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë.
- Kapitali i Shoqërisë nga 2,958,978,165 (dy miliardë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë,

**bëhet:**

**2,982,418,805 (dy miliardë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy milion e katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesë) lekë**, i cili zotërohet 100% (njëqind për qind) nga Ortaku Balfin Shpk.


3. Autorizohet Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë, znj. Blerina DAKA, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

Meqënëse nuk kishte çështje të tjera për të shqyrtuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur. Ky vendim i Asamblesë së Përgjithshme të "Albchrome Holding" SHPK mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901/2008 dhe nënshkruhet rregullisht nga Kryetari dhe Sekretari.

\*\*\*\*\*


**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË  
ALBCHROME HOLDING SH.P.K.**

**KRYETARI**

  
Znj. Edlira MUKA



**SEKRETARI**

  
z. Fatos KALESHI